



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
THE MUNICIPALITY SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



R R E G U L L O R E
P Ë R
NDARJEN E SUBVENCIONEVE

Suharekë, 2013

Në pajtim me nenin 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008, datës 4 qershor 2008), neni 43, paragrafi 3, Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit 02-Shpenzimi i Parave Publike, Udhëzimit Administrativ nr. 2005/08, MEF-it-Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve dhe neneve 27, 28 dhe 29, paragrafi 2, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 30.01.2013, miratoi;

R R E G U L L O R E N P Ë R N D A R J E N E S U B V E N C I O N E V E

DISPOZITAT E PËRGJTHSHME

Qëllimi

Neni 1.

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret, procedurat dhe i mundëson organizates specifike buxhetore ta bëjë një pagesë nga kjo kategori e ndarjes së mjeteve të buxhetit të komunës–fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale, personave fizik dhe juridik.
2. Bazuar në fondin e ndarë buxhetor të subvencioneve dhe transfereve për vitin aktual, Kryetari i Komunës sipas kërkesave të arsyetuara të palëve, ndan mjete financiare buxhetore–ndihmë momentale, për personat juridik dhe fizikë sipas procedurës së përcaktuar me këtë rregullore.
3. Subvencionet përfshijnë të gjitha transferet e njëanshme, të pakthyeshme në llogarinë rrjedhse, ndërsa transferet janë pagesa të njëanshme, jo të kthyeshme për qeveritë tjera, institucionet joprofitabile, familjet dhe individët.
4. Pagesa e pakthyeshme është e njëanshme atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim për pagesen.
5. Pagesa e subvencioneve dhe transfereve duhet të bëhen përmes transfereve bankare.

Neni 2.

Ndihmë momentale sipas kësaj rregulloreje konsiderohet ndihma e menjëhershme në para të gatshme, përmes llogarisë rrjedhëse që propozohet nga komisioni përkatës i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës, për kodet buxhetore që kanë subvencione dhe të miratuar nga ai

Neni 3.

Ndihma momentale për personat juridik (institucionet jofitimprurëse) dhe personat fizik përfshinë mbështetjen që u jepet institucioneve kulturore amatore, sportive amatore, organizatave jo qeveritare (OJQ) dhe personave fizik me nevojë.

Neni 4.

Ndihmë momentale për personat juridik (institucionet jofitimprurëse)

1. Kërkesat e personave juridik për subvencione duhet t'i drejtohen Kryetarit të Komunës përmes zyrës së pranimit. Kërkesa duhet të jetë e kompletuar me dokumentacionin mbështetës si:

- 1.1. certifikatën e regjistrimit,
- 1.2. arsyetimi i kërkesës me provë të qartë dhe bindëse si dhe
- 1.3. numri i llogarisë bankare të personit juridik jofitimprurës.
- 1.4. informatë vjetore mbi aktivitetin dhe qarkullimin financiar.

Neni 5.

- 5.1 Kryetari i komunës pas pranimit të kërkesës, e autorizon drejtorinë përkatëse, të jep mendim profesional për përfituesit në afat prej 15, ditësh.
- 5.2 Pas shqyrtimit të kërkesës, drejtoria përkatëse i propozon Kryetarit të Komunës për miratim kërkesën e justifikuar dhe të dëshmuar me dokumentacionin përcjellës, konform dispozitave ligjore të kësaj rregullore.

Neni 6.

1. Kryetari i Komunës, merr vendim lidhur me kërkesën e personit juridik, deri në shumën e përcaktuar me këtë rregullore.
2. Kryetari i Komunës sipas paragrafit 1 të këtij neni, lejon ndarjen e subvencioneve për persona juridik deri në shumën prej **5000€**.
3. Pavarësisht propozimit të Drejtorit të Drejtorisë përkatëse, Kryetari i Komunës mban të drejtën të financoj projektin pjesërisht apo plotësisht për persona juridik dhe fizikë, në bazë të arsyeshmëris dhe provave të prezantuara.
4. Nëse ndihmat financiare kanë të bëjnë me shumë më të madhe, se që është përcaktuar në paragrafin 2, të këtij neni dhe në paragrafin 1, të nenit 11, të kësaj rregulloreje, për të njëjtën vendosë Komiteti për Politikë dhe Financa me pëlqim paraprak mbi delegimin e kësaj kompetence, kurse Kuvendit i paraqitet raport për çdo gjashtë (6) muaj.

Neni 7.

Subvencionimi në fushën e arsimit

1. Përkrahje financiare për organizimin e aktiviteteve shkollore: gara të ditorisë, gara sportive, konkurse letrare, manifestime të ndryshme në nivel shkolle dhe në nivel komunal e më gjerë.

2. Përkrahje financiare për organizimin e festivaleve të nxënësve me karakter garues si: festivali i valleve, festivali i dramës, festivali i poezisë, festivali i recitimit etj, varësisht prej kërkesave dhe organizimeve të shkollave.
3. Përkrahje të qëndrueshme financiare për përfitimin e bursave për studentë të Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës dhe bursa për nxënës të shkollave të mesme (për fëmijët e dëshmorëve dhe rastet sociale).
4. Përkrahje të qëndrueshme financiare e iniciativave të Këshillit Komunal të Prindërve, që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë në arsim.
6. Përkrahje financiare për botimin e librave nga ana e nxënësve, mësimdhënësve me karakter edukativo-arsimor.
7. Përkrahje financiare (bashkëfinancim me organizatorët) për nxënësit pjesëmarrës në garat ndërkombëtare siç janë olimpiadat e diturisë etj, që organizohen brenda dhe jashtë shtetit të Republikës së Kosovës.
8. Pagesa e transportit të nxënësit nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas, distanca mbi 4 kilometra për një drejtim, vetëm për nxënësit e shkollave të obligueshme.
9. Mbulimin e shpenzimeve për vdekjen e mësimdhënësit.

Neni 8.

Kriteret për financimin e projekteve nga subvencionimi

1. **Projektet nga fusha e kulturës** (Promovimet e vlerave të festivaleve, koncerteve, shënimin e datave historike dhe kulturore, simpoziumet, ekspozitave dhe promovimi i librave të botuara etj). Shumat e mjeteve caktohen sipas strukturës komplekse të projektit (promovimet);
 - 1.1. Veprimtaria botuese (bëhet kryesisht për shpenzimet e shtypit, ndërsa donacioni fitohet në bazë të recensionit nga dy krijues të verifikuar në lëmin përkatës letrare);
 - 1.2. Veprimtaria teatrale (vlerësimi bëhet në bazë të kalkulimit të shpenzimeve të shfaqjeve teatrale);
 - 1.3. Veprimtaria filmike (vlerësohet sipas pozicioneve buxhetore të shpenzimeve të kalkuluar sipas zhanrit dhe skenarit në vlerë prej 30 deri në 40%, pasi pozicionet filmike janë më të shtrenjta se ato teatrale);
 - 1.4. Artet pamore (subvencionohet botimi i katalogëve dhe kornizimi i pikturave);
 - 1.5. Trashëgimia kulturore (hulumtimi i trashëgimisë, gërmimet arkeologjike, ruajtja, restaurimi dhe konservimi i vlerave të trashëgimisë mbështetet sipas rëndësisë së objekteve që duhet hulumtuar dhe ruajtur dhe atë në fazë. Vlerësimi për ndarjen e shumave bëhet sipas mendimit të ekspertëve të fushës së caktuar në lartësi deri në 40% pasi gërmimet, restaurimet dhe konservimet janë të kushtueshme.
 - 1.6. Grupet Artistike të Suharekës (puna e tyre vlerësohet duke u mbështetur në realizimin e suksesshëm të programeve të mirëfillta që kanë vlera artistike. Projektet e tyre që duhet mbështetur janë: pjesëmarrja në

festival në vend, mundësisht edhe jashtë vendit, koncertet e ndryshme në qytet dhe në Kosovë, pajisjet me gardërobë konvencionale dhe instrumente muzikore, ndihmat logjistike-sigurimi i sallave për mbajtjen e koncerteve, lokalet ku do t'i përgatitin programet, automjetet për udhëtime të shkurtra dhe ndonjë ndihmë tjetër ku Komuna nuk ka shpenzime të theksuara).

1.7. Projektet duhet të ketë vlera krijuese artistike.

2. Projektet nga fusha e manifestimeve kulturore, datave historike, akademitë përkujtimore dhe aktivitet tjera që organizohen nga Komuna si më poshtë :

- 2.1 Organizimi festiv për “17 shkurtin” shpallja e pavarësisë
- 2.2 Organizimi festiv për “13 qershorin” dita e Çlirimit të Suharkës
- 2.3 Organizimi festive për “Diafestin”
- 2.4 Organizimi festiv për “Festarin”
- 2.5 Organizimi për akademi përkujtimore për “Ukë Bytyçi”
- 2.6 Aktivitet tjera që organizohen nga Komuna e Suharekës.
- 2.7 Këto projekte do të subvencionohen nga Komuna në mungesë të donatorëve.

3. Projektet në fushën e rinisë të cilat janë të arsyetuar dhe të bazuar në Ligjin për pjesëmarrje dhe fuqizim të rinisë, në udhëzimet administrative që bëjnë implementim e ligjit të lartcekur i cili përcakton obligimet e Komunës kundrejt Qendrave Rinore, Këshillit të veprimt rinor lokal dhe punës vullnetare me të rinj).

4. Projektet në fushën e sportit;

- 4.1. Masivizimi i sportit për të rinj;
- 4.2. Bashkëpunim me drejtoritë të cilat merren me punën e të rinjve dhe të rejave për masivizimin e sportit dhe ngritjes kualitative të sportistëve;
- 4.3. Përkrahje të qëndrueshme financiare për sportistët kulmor dhe klubet kualitative, të cilat mund të arrijnë rezultate të mira sportive;
- 4.4. Avancimin e organizimit në klubet sportive të femrave të cilat veprojnë në rrafshin sportiv Kosovar (masivizimi i sportit ndër femra);
- 4.5. Bashkëpunimi me Organizata të ndryshme sportive vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të realizimit të projekteve të ndryshme sportive që kanë të bëjnë me ngritjen dhe avancimin e trajnerëve të cilët punojnë me grupmosha të ndryshme;
- 4.6. Integrimin e minoriteteve në aktivitete dhe në gara të rregullta kosovare;
- 4.7. Kultivimin dhe avancimin i kualiteteve menaxhuese, në mënyrë që me anë të animimit të donatorëve të gjenden mjete plotësuese financiare për funksionimin profesional dhe amator të Klubeve sportive;
- 4.8. Përkrahje të vazhdueshme për Shoqatat e Pedagogëve të Kulturës Fizike me qëllim të zhvillimit të Ligës shkollore në nivel lokal dhe rajonal;

- 4.9. Partneritet me të gjitha organizatat sportive për implementimin e politikave zhvillimore afat shkurtë dhe afat gjatë;
- 4.10. Punë e vazhdueshme edukative me tifozët që janë pjesë përbërëse e Sportit, me qëllim të evitimit të dhunës dhe me qëllim të kultivimit të vlerave fisnike të sportit;
- 4.11. Përkrahja e organizimit të klubeve për persona me aftësi të kufizuara.

5. Kriteret për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të OJQ-ve:

- 5.1. Promovimi i vullnetarizmit (aktivitetet për shërbime të arsimit ,evokim, kampanjë, menaxhment, aktivitete komunitare dhe ambiente etj.);
- 5.2. Integrimi i grupeve të marginalizuara;
- 5.3. Fuqizimi i organizatave rinore (seminare, trajnime, kurse për aftësimin e të rinjve);
- 5.4. Edukimi joformal (stimulimi i të miturve për edukim dhe arsimim);
- 5.5. Punësimi i të rinjve dhe
- 5.6. Infrastruktura për rinë, për moshën e mesme, pleq dhe pensionist.

6. Kërkesa duhet të këtë provat si në vijim:

- 6.1. Projekt-propozimi (në projekt propozim duhet të përshkruhet aktiviteti me agjendën e planifikuar si dhe specifikimi i projektit);
- 6.2. Certifikata e OJQ-së ;
- 6.3. Fotokopja e kartelës së xhirollogarisë dhe letërnjoftimin e bartësit të kartelës;
- 6.4. Shënimet e personit kontaktues.

Neni 9

Projektet nga fusha e të drejtave të njeriut dhe barzisë gjinore që promovojnë:

- 1. Projektet duhet të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut në gjitha fushat jetësore, (barazia gjinore dhe mundësitë e barabarta, drejtat e fëmijëve, drejtat e personave me aftësi të kufizuara, drejtat e minoriteteve etj.
- 2. Shuma e mjeteve caktohet sipas vlerësimit të prioritetit të çështjeve të cilat trajtohen dhe sipas lartësisë së mbështetjes nga ana e donatorit (nëse ka donator).
- 3. Pagesa e transportit për realizimin e projekteve jashtë komunës për përfitues-banorë të Komunës së Suharekës.
- 4. Përkrahja financiare për promovime mediale të projekteve të të drejtave të njeriut.
- 5. Përkrahja financiare për realizimin e fushatave vetdijësuese, ligjërata, broshura , fletëpalosje, pllakate etj.
- 6. Përkrahjen në aftësimin e përkthyesve të shenjave për personat me pengesa në të dëgjuar si kategori e veçantë) si dhe projektet tjera me interes për këtë çështje
- 7. Përkrahje për manifestime të ndryshme për promovime të drejtave të njeriut.

8. Projektet në fushën e personave me aftësi të kufizuar (mbulimi i shpenzimeve të qirasë) në rast nevojë dhe për projekte tjera për fuqizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, organeve të saja (Handikos) etj.

Neni 10

Subvencionet për individë dhe familje

Kryetari i Komunës, sipas kërkesave të arsyetuara ndanë ndihmë momentale nga fondi për transfere dhe subvencione të Komunës, për raste urgjente të shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, mbështetja financiare për varrimin e më të afërmeve, varfëri të skajshme për familje apo individ të caktuar me sëmundje të rënda që kërkojnë mjekim të kushtueshëm.

Neni 11

1. Kryetari i Komunës, lejon ndarjen e subvencioneve për persona dhe familjet në nevojë si ndihmë materiale për përkujdesje sociale dhe shëndetësore, shumë e cila mund të jetë deri në 3000€.
2. Ndihma materiale e cekur në paragrafin 1 të këtij neni, nënkupton sigurimin e të hollave, ushqimit, shpenzimet e varrimit apo kompensimin e trajtimit të domosdoshëm mjekësor për një individ apo familje.

Neni 12

1. Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i ndihmës materiale-financiare;
 - 1.1. Sëmundja e rëndë e konstatuar me dokumentacionin mjekësor të specialistit;
 - 1.2. Gjendja e rëndë ekonomike – familjare e vërtetuar;
 - 1.3. Dëshmia e shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve të tjera dhe
 - 1.4. Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e mundshme elementare, dhe
 - 1.5. Dëshmia certifikate e vdekjes

Neni 12

Kërkesë për ndihmë momentale mund të paraqesin vetëm personat dhe familjet që janë banorë të përhershëm të Komunës së Suharekës.

Neni 13

Organi kompetent për shqyrtimin e kërkesave

1. Komisioni i formuar nga Kryetari i Komunës në përbërje të zyrtarëve të Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, Drejtorisë për arsim dhe Drejtorisë për kulturë, rini dhe sport është kompetent për shqyrtim të kërkesës eventuale për ndihmë momentale individit apo familjes dhe në afat prej 15 ditësh të bënë propozimin e mundshëm për ndihmë momentale.
2. Kërkesat e pakompletuara, komisioni nuk do t'i procedoj më tutje.
3. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për ndihmën momentale do të refuzohen nga Kryetari i Komunës me propozim të Komisionit.

Neni 14

Shuma e ndihmës momentale për personat fizikë dhe familjar propozohet nga Komisioni deri në limitin e përcaktuar në nenin 11 paragrafi 1 të kësaj rregulloreje. Personi dhe familja e caktuar mund të ndihmohet vetëm një herë në vit me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

Neni 15

Komisioni, listën e specifikuar të propozuar për ndihmë momentale ja dorëzon Kryetarit të Komunës, i cili ka mundësi ta ndryshojë para se të propozohet për miratim, duke potencuar arsyetimin për ndryshime.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Në raste konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe dispozitave të rregullave financiare dhe udhëzimit thesarit 02-shpenzimi parave publike dhe Udhëzimi Administrativ nr. 2005/08, MEF-it, klasifikimi ekonomik i shpenzimeve, do të aplikohen dispozitat e këtyre të fundit.

Neni 17

Për zbatimin-implementimin e kësaj rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqeni sociale, Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet, Drejtoria për arsim dhe Drejtoria për kulturë, rini dhe sport e Komunës së Suharekës.

Neni 18

Kjo rregullore mundë të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, me propozimet e arsyetuare.

Hyrja ne fuqi

Neni 19.

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, kjo rregullore hynë ne fuqi 8, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008) dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 16-586
Data 30.01.2013



Kryesuesi i Kuvendit

V. Maliqaj
Vesel Maliqaj